

Raport Muaji Korrik 2024

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Shoqëria Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	Euro
Datë Lancimi	22 Nentor 2012
Vlera fillestare e kuotës	100
Shuma fillestare minimale	250
Shuma minimale pasuese	50

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0.00%
Tarifë në dalje	0.00%
Tarifë Administrimi në vit	Deri ne 1.30% e vleres neto te aseteve

Tarifa te tjera te vazhdueshme **Referojuni prospektit te fondit**

Komisione/tarifa të vazhdueshme **1.50% per vitin 2023**

Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta **Referojuni informacionit ne deget e RBAL**

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të mund t'i sigurojë investitorit një kthim nga investimi në përputhje me një menaxhim të kujdesshëm të portofolit duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetit të nevojshëm.

Nje pjese e rendesishme e asetëve të fondit mund të investohen në bono dhe obligacione thesari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të emtuara në monedhën euro. Megjithatë, frekuenca e emtimeve në euro nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të përcaktojë shkallën në të cilën Fondi do të investojë në këto lloje instrumentash.

Fondi është i përshtatshëm për individë dhe subjekte juridike të cilët mendojnë se objektivi i investimit i Fondit përputhet me kërkesat dhe pritshmeritë e tyre.


Shifra e tarifave të vazhdueshme 1.50% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2023. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund të kalojë maksimumin prej 1.6% në vit të vlerës neto të asetëve të fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëvendërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.

Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë
Përfitimet tipike më të larta



Fondi Raiffeisen Invest Euro është në kategorinë e tretë të Profilit të Riskut dhe Përfitimit

Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk.

Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 31 Korrik 2024


Vlera Neto e Aseteve	€ 34,317,040
Numri I Investitoreve	1,523
Cmimi I Kuotes	112.8241
*Kthimi Vjetor nga Investimi (31.07.2023 – 31.07.2024)	4.09%

*Tarifa e administrimit dhe tarifatat e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

Struktura e Portofolit të investimeve më 31 Korrik 2024

Portofoli i fondit Euro është ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga balancimi i kategorive të ndryshme të investimeve në bono dhe obligacioneve qeveritare dhe të korporatave. Kjo bëhet me qëllim për të diversifikuar portofolin dhe ulur riskun që vjen nga ekspozimi i gjere ndaj pak instrumenteve.

Përqindja e alokimit të asetëve bëhet në përputhje me politikën e investimit dhe kriteret të specifikuar në prospektin e fondit. Shpërndarja e asetëve mund të jetë jashtë objektivit të përcaktuar për shkak të ndryshimeve të kushteve të tregut. Asetet e Fondit janë të investuara në instrumente financiare që i përkasin emetuesve që performojnë në industri të ndryshme të ekonomisë duke bërë të mundur rritjen e diversifikimit të portofolit.




Duke iu referuar strukturës së portofolit të investimeve të fondit më 31 Korrik 2024, përqindja e asetëve të fondit e investuar në Obligacione Shtetërore është në 54.35% të asetëve dhe 40% i përkasin obligacioneve të emetuara nga Qeveria Shqiptare. Fondi mund të balancojë ekspozimin ndaj instrumenteve të ndryshme në varësi të kushteve të tregut për të arritur objektivat e tij afatgjatë. Asetet e fondit të investuara në obligacione korporatash me vlerësim të lartë dhe në fonde investimesh përbëjnë 41.1% të totalit të aktiveve. Keto fonde investimi gjithashtu kanë në fokus investime në tregun e obligacioneve. Likuiditeti i mbajtur në cash dhe depozita është zvogeluar në nivelin 4.5% e totalit të asetëve të fondit. Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin 34.31 milionë EUR në fund të muajit Korrik.

Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës gjatë muajit Korrik

Gjatë muajit Korrik cmimi i kuotes së fondit ka pësuar rritje me **+0.84%**, duke rezultuar muaji me performancën më të lartë mujore gjatë vitit 2024, deri tani.


Korriku ishte një muaj pozitiv për tregun e obligacioneve në teresi, me yield-et që u ulën ndjeshëm në SHBA dhe Europë. Shifrat e inflacionit në SHBA rezultuan me mirë seç pritej dhe ky fakt rriti më tej shpresat se një ulje e normës nga ana e Rezervës Federale mund të vijë më shpejt. Si rrjedhojë, yield-et më të ulëta të obligacioneve qeveritare dhe obligacioneve të korporatave paten efekt pozitiv në portofolin e investimeve të fondit Raiffeisen Invest Euro, i cili rregjistroi fitime përgjatë muajit.

Yield-i mesatar i portofolit të investimeve të fondit ishte 4.03% për një kohëzgjatje mesatare prej 3.43 vjet më 31 korrik.
Kthimi neto vjetor i fondit është +4.09% më 31 Korrik 2024.



Ne dt 31 Korrik 2024	1 Vit	2 Vite	3 Vite	5 Vite	10 Vite	Nga lancimi (22 Nentor 2012)
Kthimi në % p.a per periudhen	+4.09%	+2.87%	-1.66%	-1.11%	+0.60%	+1.04%

Kthimi Neto i fondit Raiffeisen Invest Euro per çdo vit



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon në varësi të kushteve të tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Luhatshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve të investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitorët e fondit Raiffeisen Invest Euro dhe të gjithë fondëve të administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen të kenë një horizont sa më të gjatë investimi për të përfituar një kthim optimal nga investimi dhe në këtë mënyrë në periudhë afatmesme apo afatgjatë të kenë mundësi të rikuperojnë edhe efektet negative të krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen që të ruajnë investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qëndrimit në fond të nxitur nga situatat jo të zakonshme të krijuara përkohësisht në tregjet financiare, sepse në këtë mënyrë nuk do të riskojnë të dalin nga fondi në momentin e gabuar për investimin e tyre.

Zhvillimet dhe informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare gjatë muajit Korrik

Inflacioni total në Eurozonë u rrit lehtë nga 2.5% në qershor në 2.6% në korrik, ndërsa inflacioni bazë mbeti i pandryshuar në 2.9%. Rimëkëmbja e eurozonës vijoi me një ritëm të moderuar në tremujorin e dytë, me një rritje prej 0.3% të PBB-së dhe normalisht pritet që të ketë një nxitje të vogël edhe nga Lojërat Olimpikë të Parisit në tremujorin e tretë.

Në SHBA, shifrat e inflacionit u përmirësuan në qershor, me rritjen e inflacionit bazë me vetëm 0.1% në baza mujore. CPI vjetore bazë shenoi rënie nga 3.4% në 3.3%, ndërsa norma e indeksit të inflacionit me të gjithë zërat ra nga 3.3% në 3%, më shumë sesa pritshmerite e tregut.

Shifrat më të mira të inflacionit çuan në ulje të yield-ëve të obligacioneve dhe tregu i obligacioneve gjeneroi ecuri të mirë në muajin Korrik. Tregu i obligacioneve përfitoi nga rënia e yield-ëve për shkak të zbehjes së presioneve inflacioniste dhe rritjes së pritshmerive për ulje të normave të interesit nga ana e Bankave Qendrore. Obligacionet e korporatave përfituan gjithashtu nga rënia e primeve të riskut dhe përmirësimi i ndjenjës së riskut pas rezultatit të zgjedhjeve në Francë.

Vendimi i Bankës Qendrore Evropiane për të lënë të pandryshuar normën e interesit në Korrik dhe për të mos dhënë sinjale të qarta për vijueshmëri ishte në përputhje me pritshmëritë e tregjeve. Ulja e normës së interesit në shtator do të varet nga zhvillimi i të dhënave ekonomike.

Nuk pati asnjë ndryshim surprize nga Rezerva Federale e SHBA në takimin e saj të muajit Korrik, duke lënë të pandryshuar normën e interesit në intervalin 5.25% dhe 5.50%, por kishte disa ndryshime në deklaratën shoqëruese, e cila përfshinte një zhvendosje nga qëndrimi i meparshëm i politikës shtrënguese në një qëndrim më neutral. Rritja vjetore prej 2.8% e PBB-së së SHBA-së ishte më e fortë sesa vlerësimet e tregut prej 2.0%, por tregu i punës në SHBA po jep shenja dobësie, gjë që duhet të mbështesë një ulje të normës së interesit nga Rezerva Federale në mbledhjen e ardhshme të muajit shtator.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analizë të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sh.a., në faqen zyrtare www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.